



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.328/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret : Ramush Bardiqi kryesues, Kujtim Pasuli, dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatoret dhe Intelektualet, me seli në Komuna Prishtinë, kundër Subjektit Politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.02.2025, merr këtë :

V E N D I M

REFUZOHEN të pa bazuara ankesat e Koalicionit AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatoret dhe Intelektualet, me seli në Komuna Prishtinë, Anr.328/2025 dhe Anr.329/2025 të datës 03.02.2025, të parashtruara kundër Subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 03.02.2025 PZAP-i ka pranuar ankesat nga Koalicioni AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatoret dhe Intelektualet, të identifikuar me numër Anr.328/2025 dhe Anr.329/2025, ku në ankesën Anr.328/2025, theksohet se me datë 02.02.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Lista GUXO dhe lista Alternativa, ka mbajtur fushatën zgjedhore në qytetin e Lipjanit, përkatësisht në sheshin Adem Jashari, duke filluar nga ora 17:00. Gjatë mbajtjes së fushatës politike, kandidati për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, z. Glauk Konjufca, në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përdorur gjuhë të papërshtatshme gjatë fjalimit të tyre, e cila ndër tjerash nxitur urrejtje kundër të tjerëve, ku gjatë fjalimit, z. Glauk Konjufca, ndër tjerash ka deklaruar se: *“A i keni pa partitë tjera i kanë vendos kryetaret e komunave? VV i ka gjashtë kryetarë, a kishim mujt edhe na? Shumë kollaj ka genë. Edhe secilin që pe pyetnin po thojnë jo kam me nejt në komunë? Çka është ky mashtrim kështu? Kjo është si me porosit miell e me të dal byk? Këta partitë politike që po na luftojnë po e bëjnë që popullit me ia pështille, e me ju dok që lufta është për kryetarë të komunave, e lufta është për kryeministër të Kosovës. E i kam dëgjua që VV është në panik, pikërisht ata që i kanë vendos kryetaret e komunave, ata janë në panik, p’ e përdorin pushtetin komunal, resurset komunale për me mbledh më shumë vota me kushtëzime*

e shantazhe. Por, na nuk kemi panik se e kemi popullin'. Në këtë formë, kandidati për deputet i Vetëvendosjes, Glauk Konjufca, ka sulmuar partitë opozitare nga tubimi në Lipjan për përfshirjen e kryetarëve të komunave në listat e kandidatëve për deputetë. Konjufca e quajti "mashttrim" një lëvizje të tillë, duke i krahasuar me "byk", theksohet në ankesë. Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë: [https://nacionale.com/politike/konjufca-krahason-opoziten-me-byk-i-kanevendose-kryetaret-e-komunave-ne-lista për deputete](https://nacionale.com/politike/konjufca-krahason-opoziten-me-byk-i-kanevendose-kryetaret-e-komunave-ne-lista-për-deputete).

-Në ankesën 329/2025, pretendohet se me datë 02.02.2025, subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), Lista GUXO dhe lista Alternativa, ka mbajtur fushatën zgjedhore në qytetin e Lipjanit, përkatësisht në sheshin Adem Jashari, duke filluar nga ora 17:00. Gjatë mbajtjes së fushatës politike, kandidati për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, z. Albin Kurti, në kundërshtim me dispozitat ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, ka përdorur gjuhë të papërshtatshme gjatë fjalimit të tyre, e cila ndër tjerash ka nxitur urrejtje kundër të tjerëve. Kandidati për deputet, e tani kryeministër aktual, z. Albin Kurti gjatë fjalimit të tij, ka deklaruar: " Veç ata që s'i duan familjet e veta e fëmijët e vet, ata mujnë mos me votuar për Vetëvendosjen e me votu për vete. Por nëse i dojnë familjet e fëmijët, prindërit e vet ata duhet me votu për Vetëvendosjen. Se veç na kemi program për këto kategori shoqërore." Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si provë: <https://nacionale.com/politike/kurti-eskalon-si-kurre-me-para-vec-kush-si-do-fëmijët-e-familjen-e-vet-nuk-voton-për-vetëvendosje>.

-Në përgjigjen në ankesën Anr.328/2025, theksohet se nga pretendimet ankimore të ankuesit dhe provat e bashkangjitura ankesës në asnjë rrethanë nuk mund të provohet fakti se deklarata e Krye parlamentarit Glauk Kojufca në tubimin e mbajtur në qytetin e Lipjanit përkatësisht fjalitë e përdorura nga i njëjti përbëjnë shkëlqje të dispozitave të nenit 34 paragrafi, pika 1 1 e LZP-së për faktin se: fjala byk apo miell në fjalorin e gjuhës shqipe nuk konsiderohen si fjale denigruese apo përcarëse.

Në përgjigjen në ankesën Anr.329/2025, theksohet se nga pretendimet ankimore të ankuesit dhe provat e bashkangjitura ankesës në asnjë rrethanë nuk mund të provohet fakti se deklarata e Kryeministrit Kurti përkatësisht ftesa drejtuar të pranishmëve në tubim për të votuar subjektin politik LVV është apriori gjuhe nxitëse denigruese apo manipulim me ndjenjat e qytetarëve siç pretendon ankuesi. Është e drejtë e pa mohueshme e kryetarit të subjektit politik, garues në zgjedhjet parlamentare të ftoj votuesit potencial për të votuar subjektin politik të cilin e drejton e që në rastin konkret është Lëvizja Vetëvendosje!

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosi të Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.328/2025, dhe Anr.329/2025, të datës 03.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.328/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga Koalicioni AAK-Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, NISMA-Nisma Socialdemokrate, Konservatorët dhe Intelektualet, kundër subjektit të njëjtë politik LVV, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 3 të LZP-së, konstatoi se:

-Ankesat janë të pabazuara.

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruara si provë materiale, ka gjetur se kandidatët e subjektit politikë LVV, dhe atë: z. Glauk Konjufca kandidati për deputet nga radhët e këtij subjekti politik ka deklaruar se: *“A i keni pa partitë tjera i kanë vendos kryetaret e komunave? VV i ka gjashtë kryetarë, a kishim mujt edhe na? Shumë kollaj ka qenë. Edhe secilin që pe pyetnin po thojnë jo kam me nejt në komunë? Çka është ky mashtrim kështu? Kjo është si me porosit miell e me të dal byk? Këta partitë politike që po na luftojnë po e bëjnë që popullit me ia pështille, e me ju dok që lufta është për kryetarë të komunave, e lufta është për kryeministër të Kosovës. E i kam dëgjua që VV është në panik, pikërisht ata që i kanë vendos kryetaret e komunave, ata janë në panik, p ‘e përdorin pushtetin komunal, resurset komunale për me mbledh më shumë vota me kushtëzime e shantazhe. Por, na nuk kemi panik se e kemi popullin’, kandidati për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, z. Albin Kurti, ka deklaruar:” *Veç ata që s’i duan familjet e veta e fëmijët e vet, ata mujnë mos me votu për Vetëvendosjen e me votu për vete. Por nëse i dojnë familjet e fëmijët, prindërit e vet ata duhet me votu për Vetëvendosjen. Se veç na kemi program për këto kategori shoqërore,”* Paneli vlerëson se në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Diskursi i tillë i përdorur nga kandidatet për deputet nga radhët e këtij subjekti politik z.Glauk Konjufca dhe z.Albin Kurti dhe nuk mund të konsiderohet se përdorimi i një gjuhe të tillë mund të nxit ose provokon, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nuk është në kundërshtim me nenin 34 pika l.11), e LZP-së, në të cilin nen në mënyrë decisive thuhet se: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”.**

Andaj Paneli, bazuar në provat e ofruara ka ardhur në përfundim se gjatë mbajtjes së fushatës zgjedhore të mbajtur me datë 02.02.2025 në qytetin e Lipjanit kandidatet për deputet nga radhët e subjektit politik LVV, ka vlerësuar se përdorimi i një gjuhe të tillë nuk bie në kundërshtim me nenin 34 pika l.11), e LZP-së. Nga arsyet e theksuara me lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr.328/2025 më datë 05.02.2025

Kryesues i Panelit,
Ramush Bardiqi



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.